



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

Njoftim për konsultim publik

Titulli i Projekt-aktit :

1. “**PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË NË BASHKINË KORÇË (2025-2028)**”
2. “**PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 – 2030**”
3. “**PLANI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2028**”

Propozuesi : *Bashkia Korçë.*

Sqarime për projekt-aktin:

Planet janë dokumenta strategjikë të cilat do përcaktojnë, analizën e situatës, prioritetet për të ndërmarrë veprime konkrete, planet e veprimit, strukturat përgjegjëse për veprim, kostot e përfafërta etj për përmirësimin e gjëndjes për Rininë dhe barazinë gjinore.

Kalendari i konsultimit : Konsultimi publik do të realizohet sipas kalendarit të konsultimeve.

Pjesëmarrës :

- **Nga ana e Bashkisë :** Adminitrata dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak
- **Nga komuniteti :** Grupet e interesit, grupet formale dhe informale të të rinjve, të mbrojtjes së barazisë gjinore.

Format e konsultimit : Takime fizike ku do prezantohen planet dhe do merren mendimet për përmirësimin e tyre

Qëllimi i konsultimit publik	<i>Përpara vendimarrjes se planeve te veprimit nga ana e këshillit është e nevojshme të merret mendimi komuniteti dhe grupeve të interesuara për rininë dhe barazinë gjinore në lidhje me parashikimet e këtyre Planeve.</i> - <i>Plani Lokal i Veprimit për Rininë në Bashkinë Korçë është hartuar në bashkëpunim me grupet e të rinjve (rreth 150) nga ana e Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Qendrën për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri, me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrit të Shtetit për të Rinjtë dhe Fëmijët.</i> - <i>Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 – 2030 u përgatit nga Bashkia Korçë me mbështetjen e UN Women Shqipëri.</i>
------------------------------	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË KËSHILLI BASHKIAK

	- <i>Plani i Arsimit Parauniversitar 2026-2028 u përgatit nga Bashkia Korçë me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të "Smart Processes".</i> <i>Pavarësisht takimeve dhe konsultimeve që kanë bërë grupet e punës, këshilli i Bashkisë kërkon mendimet dhe sygjerimet e grupeve të interesit për të pasur një vendimarrje të dakortësuar sa më gjerë dhe si pasojë e detyrimit ligjor që ka në zbatim të nenit 18, ligji nr. 139/2015.</i>
Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti	<i>Planet e Veprimit si dokumenmta strategjike trajtojnë analizën e situatës, prioritetet për të ndërmarrë veprime konkrete, planet e veprimit, strukturat përgjegjëse për veprim, kostot e përfafërta etj për përmirësimin e gjëndjes për Rininë dhe barazinë gjinore dhe arsimit parauniversitar.</i>
Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	<i>Këshilli i Bashkisë Korçë nëpërmjet këtij konsultimi publik kërkon të tërheqë mëndimin e komunitetit dhe grupeve të interesuara ku ndër më kryesoret janë:</i> <i>- Cfarë veprimesh konkrete mund të ndërmeren nga pushteti lokal si dhe nga aktorët e tjeërë për çështjet e rinisë dhe barazosë gjinore dhe arsimit parauniversitar?</i> <i>- Ku duhet të fokusohen prioritetet dhe investimet ne fushen e arsimit parashkollor universitar?</i> <i>- A janë veprimet e parashikuara në këto plane efektive dhe të realizueshme dhe si mund të përmirësohen?</i> <i>- A janë prioritetet dhe ndërhyrjet e parashikuara të nevojshme apo ka prioritete dhe ndërhyrje të tjera të nevojshme për territorin e Bashkisë Korçë?</i> <i>Pjesëmarrësit mund të japin mendime dhe sygjerime të tjera mbi temat e trajtuara në këto plane veprimi.</i>
Detaje të çdo takimi publik apo dëgjese publike që do të organizohet në lidhje me projekt-aktin për këshillim;	<i>Takimet do të organizohen në sallën e mbledhjeve të Këshillit dhe janë të ftuar të gjithë pjesëtarët të cilët mendojnë se mund të kontribuojnë me mendimet dhe sygjerimet e tyre.</i>
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Mendimet dhe sygjerimet tuaja do të merren gjate takimeve fizike sipas kalendarit. Gjithashtu sugjerimet janë të mirëpritura deri më datë 25 Gusht 2025, në adresen e email: eva.naci@bashkiakorce.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	<i>Ne planet e veprimit mund te parashikohen ndryshime në prioritete, ndërhyrje dhe alternativa të veprimeve konkrete që duhet të ndërmeren për përmirësimin e situatës së rinisë dhe barazisë gjinore.</i>
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet	<i>Projekt planet e veprimit mund ti gjeni dhe ti konsultoni paraprakisht në link-et:</i> - https://bashkiakorce.gov.al/2025/08/02/njoftim-1317/ - https://bashkiakorce.gov.al/2025/08/02/njoftim-1316/ - https://bashkiakorce.gov.al/2025/08/02/njoftim-1319/
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisioneve përkatëse të Këshillit dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e komisioneve (mbledhjet e komisioneve do jenë të hapur për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në planet përfundimtare. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projekt buxhetit afatmesëm dhe projekt buxhetit vjetor; 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre; 7. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 8. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

	Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	<i>Data e publikimit 02/08/2025.</i>

Kalendar i konsultimit publik

Grupet që do të konsultohen: Grupet e interesit, grupet formale dhe informale të të rinjve, të mbrojtjes së barazisë gjinore si dhe cdo individ apo subjekt i interesuar.

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Menyra	Forma
1	<i>Takim konsultues per Planin Vendor te Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 – 2030</i>	<i>E hene 25/08/2025</i>	<i>Salla e mbledhjeve te keshillit</i>	<i>Ora 10:00</i>	<i>Takim fizik</i>	Mbledhje e mendimeve dhe sygjerrime mbi draftin e aktit
2	<i>Takim konsultues per Planin e Arsimit Parauniversitar 2026-2028</i>	<i>E hene 25/08/2025</i>	<i>Salla e mbledhjeve te keshillit</i>	<i>Ora 12:00</i>	<i>Takim fizik</i>	Mbledhje e mendimeve dhe sygjerrime mbi draftin e aktit
3	<i>Takim konsultues per Planin Lokal te Veprimit për Rininë në Bashkinë Korçe.</i>	<i>E hene 25/08/2025</i>	<i>Salla e mbledhjeve te keshillit</i>	<i>Ora 14:00</i>	<i>Takim fizik</i>	Mbledhje e mendimeve dhe sygjerrime mbi draftin e aktit

Kryetaret e Komisioneve

Anxhela Taho

Llambert Malaveci

Sekretari i Këshillit

Eva Naçi